

VENDIM
Nr. 335, datë 18.12.2025

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS LIDHUR ME KËRKESËN E SHOQËRISË
“DEVOLL HYDROPOWER” SHA PËR RINOVIMIN E LICENCËS NË
VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “d”, 5, pika 1, germa “d”, 10, pikat 1 dhe 3, si dhe 16, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.12.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2825/2 prot., datë 16.12.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Devoll Hydropower’ sh.a. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Devoll Hydropower” sh.a. është licencuar në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 81, datë 9.6.2016, dhe rinovuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 134, datë 7.6.2021, me afat vlefshmërie deri më 10.6.2026.

- Ajo ka paraqitur kërkesën për rinovimin e kësaj licence, me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 2825/1 prot., datë 10.12.2025.

- Në nenin 16, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, përcaktohet se paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës bëhet jo më vonë se 6 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë (data e përfundimit të licencës nr. 343, seria F16/F21, është 10.6.2026) dhe shoqëria duhet të aplikonte brenda datës 10.12.2025.

- Sa konstatohet, shoqëria e ka paraqitur aplikimin e saj brenda afatit të parashikuar në nenin 16, pika 1 të rregullores.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe ka shlyer ndaj ERE-s të gjitha detyrimet për sa i përket pagesave të rregullimit.

- Shoqëria ka deklaruar se nuk ka ndryshime në dokumentacion nga momenti i licencimit, por duke marrë në konsideratë se dokumentacioni i licencimit i referohet dhe informacioneve/ dokumentacioneve që duhet të rifreskohen për shkak të natyrës së përkohshme të tyre, vlerësohet që t’i kërkohet të përditësojë informacionin/dokumentacionin, në vijim:

- Dëshmitë e penaltetit për administratorin dhe vetë shoqërinë;

- Vërtetimet mbi shlyerjet e detyrimeve ndaj organeve tatimore dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore;

- Sasinë e energjisë që shoqëria parashikon të furnizojë 5 vitet e ardhshme, planin e biznesit dhe mbështetjen financiare përkatëse;

- Mënyrën e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit;

- Sistemin IT për faturimin.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 343, seria F16/F21, të shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a., për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 81, datë 9.6.2016, dhe rinovuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 134, datë 7.6.2021.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Devoll Hydropower” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti